

Pyetjet e AKEP:

- 1.Keni raportuar për organizim mbledhjeje periodike si dhe masa të marra drejt kërcënimeve të mëparshme: Sa herë organizohet mbledhja dhe cilat janë masat që ju keni marrë.
- 2.Politika e Kontrollit të aksesit: Si bëhen praktikisht ndryshimet e llogarive tek përdoruesit dhe ndryshimet e privilegjeve (cfare sistemi operative dhe software përdorni)? Keni deklaruar se te gjithë përdoruesit pajisen me nje deklarate me shkrim ose elektronike mbi te drejtat e aksesit te tyre, termat dhe kushteve per perdorimin e ketyre te drejtave (Paraqiteni).
- 3.Monitorimi: Keni deklaruar se të dhënat i ruani 1 muaj për sistemet e zakonshme dhe 2 muaj për sistemet kritike. Sipas rregullores detyrimi për ruajtjen e të dhënave është 2 vjet.
- 4.Politika e Integritetit të sistemeve dhe rrjetit: Cfarë antivirusi përdorni (tipi, lloji apo modeli)?
- 5.Logs: bazuar në infrastrukturën e rrjetit tuaj, sqaroni se për cilat pajisje ruani logs?
6. Mospërmbushje e shkronjës g të pikës 1 të Nenit 6 të rregullore, ku kërkohet të keni rregullore në lidhje me sigurinë ose rregulla të mirëpërcaktuara, të publikuara dhe rregullisht të përditësuara për menaxhimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.
- 7.Mospërmbushje e shkronjës j të pikës 1 të Nenit 6 të rregullores, ku kërkohet publikim në website i udhëzuesit për përdoruesit rreth incidenteve të sigurisë.

Pergjigjet:

Pika 1. Mbledhjet organizohen sa here ka sulme te rrezikshme drejt pajisjeve kryesore teknike. Megjithate mbledhja mbahet cdo fillim muaji ne te cilat diskutohen edhe ceshtje te tjera teknike.

Pika 2. Aksesi i klientit krijohet ne radius i ngritur mbi sistem linux, ku autentikohet me user dhe pass unik pajisja e secilit klient. Password krijohet nga vete perdoruesi ne momentin qe lidh kontraten ose e ndryshon vete klienti ne Laptopin e punonjesit tone, ne banese ose ne zyren tone. Me deshiren e klientit nga ana jone mund te ndrohet vetem pass i wifi ose klienti mund ta ndroje vet duke menaxhuar pajisjen.

Pika3. Korrektojme qe te dhenat e klientave ne i ruajm 2 vjet. Sistemi i menaxhimit dhe billing eshte radius manager i ngritur ne sistem linux dhe te dhenat e radius ruhen 2 vjet.

Pika4. Ne ofrojm sherbim interneti per klientat dhe u sugjerojme atyre perdorim te antivirusëve. Perdorim vetem nje kompjuter me sistem windows per menaxhimin e pajisjeve dhe per programe te tjera, dhe aty eshte i instaluar Antivirus Microsoft Security Essential.

Pika5. Loget ruhen per sistemin e radius manager, ku autentikohet ppoe e klientit, logs te tilla si: kur useri ka qene online, koha sa ka qendruar online, kur ka qene offline, cfare faqesh web ka vizituar, sa MB ka konsumuar cdo muaj, etj. Ruhen gjithashtu edhe logs te ruterit qendror Mikrotik, ne raste sulmesh. Logset e ruterit nuk mund te ruhen per kohe pafund pasi bllokohen pajisjen per shkak se marrin shume madhesi si logse.

Pika6. Rregullorja jepet bashklidhur.

Pika7. Udhezuesi jepet bashklidhur.